



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

**KD.nr.12/2017**

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët: Nenad Lazic, kryetar, Manushe Karaqi dhe Skender Çoçaj, anëtar të Komisionit, duke e shqyrtuar çështjen e përgjegjësisë disiplinore ndaj xxxxx xxxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor ZPD-2017-008, i njëjti në procedurë te Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/07/2017, për pretendimin për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor te Kosovës (Nr.03/L-223), në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, z.Kadri Begolli dhe gjyqtarit xxxx xxxxx me datë 20.07.2017 merr këtë:

**V E N D I M**

Xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx, **nuk** është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, 1.3 dhe 1.4 shkelje e kodeve të zbatueshëm të etikes të përcaktuara sipas Ligjit për Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), siç është pretenduar në raportin përfundimtar të Zyrës se Prokurorit Disiplinor ZPD-2017-008.

**A r s y e t i m**

Zyra e Prokurorit Disiplinor i'a ka paraqitur Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Raportin Përfundimtar ZPD-2017-008 se bashku me shkresat e lëndës, më të cilin e ka ngarkuar xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2- neglizhencë në kryerjen, dështim për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore, 1.3- të dështuarit e kryerjes së funksioneve gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe të paanshme dhe 1.4-shkelje e kodit të zbatueshëm të etikes të përcaktuara sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovë.

Hetimin disiplinor e kishte iniciuar në bazë të parashtresës së u.d të kryetares së Gjykatës së xxxxx, e cila në parashtresë kishte theksuar se gjyqtari xxxx xxxx nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore, duke mos respektuar afatin ligjor për dërgimin e lëndëve Regj.nr.13108/14, Regj.nr.14915/14, regj.nr.8464/14, regj.nr.13054/14, regj.nr.14997/14, sipas ankesave në Gjykatën e Apelit. Të njëjtat i kishte dërguar pas kalimit të afatit prej 14 deri në 17 muaj pas ushtrimit të ankesave dhe si pasoj e mosrespektimit të afatit, kanë arritur parashkrimin. Në seancën dëgjimore të Komisionit të mbajtur me datë 20.07.2017 përfaqësuesi i ZPD-së deklaroi se ZPD në raportin përfundimtar të cilin ju ka dërguar juve Komision konsideron se gjyqtari

xxxxx ka kryer sjellje të pahijshme duke e neglizhuar funksionin gjyqësor në atë mënyrë që duke vepruar si gjyqtar në lëndët e përcaktuara në piken tre(3) të raportit i ka proceduar në kundërshtim me dispozitën e nenit 218 të Ligjit për Kundërvajtje.

Gjyqtari xxxx xxxxx në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinore deklaroj se lidhur me këtë seancë që po zhvillohet nuk e ndien veten fajtor dhe se të gjitha veprimet që i ka ndërmarr lidhur me këto lëndë, ka vepruar në kuadër të ligjit.

Theksoj se lënda e parë 13108/14 ka qenë vjedhje e pyllit e ushtruar nga autoriteti i pyetjeve në xxxx me datë 23.06.2014. Pas shqyrtimit gjyqësor ka prurë një aktvendim me të cilin i njëjti është shpall fajtor, këtu ka ushtruar ankesë autoriteti pyjor. Nga gjyqtarit është dorëzuar me flet dorëzime me datë 09.02.2015, ndërsa flet kthesë është kthyer 27.02.2016, sipas nenit 216 të Ligjit për Kundërvajtje, ku decidivisht thuhet, citoj “ankesa respektivisht prapësimi i paraqitur jo në kohën e duhur dhe të pa lejuar, duhet ta hudh poshtë me aktvendim gjyqtari i Gjykatës Komonale të Kundërvajtjes. Paragrafi 2 thotë, nëse gjyqtari Komunal i Kundërvajtjes, lëshon që ta hudh poshtë ankesën e cila është paraqitur ose është e pa lejuar, ankesën do ta hudh poshtë Gjykata e Lartë për Kundërvajtje. Ankesa nuk ka mundur të shkoj të trupi gjykues dhe kryetari i trupit gjykues me kohë, për arsye se ka munguar flet kthesa e të pandehurit. Me datë 27.02.2016 ka ardhur flet kthesa ndërsa gjyqtari e ka proceduar në Gjykatë Apel në divizionin për Kundërvajtje, me datë 29.02.2016.

Lënda e dytë 14915/14, të pandehurit i është dorëzuar aktvendimi nga shpërndarësi i postes me datë 19.02.2015, ndërsa është kthyer nga posta me datë 15.07.2016 dhe në momentin që e kishte kompletuar lëndën, e ka proceduar në Gjykatën e Apelit.

Lënda e tretë 8464, është vendosur me 24 shkurt 2015, ankesa është bërë me datë 20.03.2015, po atë ditë i është përcjellë me flet kthesë shpërndarësit të postes dhe nga ana e shpërndarësit të postes është kthyer me datë 18.03.2016, pra pas një viti dhe se për këtë gjyqtari nuk mbanë përgjegjësi.

Lënda 13054/14 aktvendimi është marr me 16.02.2015, flet dorëzimi është kthyer po të njëjtën ditë dhe ju ka dorëzuar trafikut regional të Gjilanit. Është kthyer me datë 18.07.2016, në momentin e kompletimit, lëndës është dorëzuar në Gjykatën e Apelit.

Lënda 14997/14 është vendosur me datë 16 shkurt 2015, dhe ju ka dorëzuar autoritetit me datë 18.03.2015, është e nënshkruar nga shpërndarësi i postes dhe autoriteti pyjor. Ankesa ka ardhur me datë 27.03.2015, por nuk kemi pas prova se kur e ka marr dhe është ankesa e ushtruar nga personi i autorizuar. Kemi bërë urdhëresë për marrje të aktvendimit dhe nga posta është kthyer me datë 27.07.2016.

Gjyqtari xxxxx deklaroj se e ka njoftuar kryetarin e gjykatës se po ka probleme me flet kthesa dhe me shpërndarësit e postes. Neni 216, 217 dhe 218 i ligjit për Kundërvajtje, decidivisht thotë se ankesa bashkë me shkresat e lëndës gjyqtari i kundërvajtjes ja dërgon Gjykatës së Lart për Kundërvajtje jo me vonë se tri ditë pasi që të konstatohet se janë plotësuar kushtet ligjore për dërgim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i ZPD-së deklaroi se janë të vetëdijshëm për problemet më të cilat ballafaqohen, në veçanti gjyqtaret nëpër divizione për kundërvajtje, se brenda punës ditore të tyre ka me kilogram shkeljesh. Organet që duhet me i ndjek nuk kanë informacione për shkak të vëllimit të madh, por kjo nuk e liron gjyqtarin nga përgjegjësia për edhe një rast për të cilën ZPD-ja ose qytetari merr informacion që ka shkelje ligjore. Nuk mundem të tolerohet që gjithë kohës në divizionin për kundërvajtje të ketë shkelje ligjore dhe parashkrime në veçanti. I propozoj Komisionit që ta aprovoj raportin dhe provat e prezantuara, gjyqtari ti shqiptoj një masë disiplinore.

Gjyqtari xxxxx në fund ju lutë Komisionit se pesë lëndët kontestuese siç po pretendon ZPD-ja i ka të kompletuara, i prezantoi në seancë, shikoni dhe do të bindeni se janë shkuar me kohë, janë flet kthesat dhe vula e postes se kur janë kthyer. Unë i kam dërguar në Gjykatën e Apelit menjëherë po sa i kam kompletuar lëndët, nga Komisioni kërkoj vetëm drejtësi dhe asgjë më tepër.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provave në shkresat e lëndës, ka dëgjuar edhe deklarata e gjyqtarit të dhënë gjatë seancës dëgjimore, dhe pasi i ka shqyrtuar dhe analizuar edhe pesë lëndët e kompletuara dhe të prezantuar nga Gjyqtari xxxxxx gjatë seancës, konstatoj se gjyqtari xxx xxxx nuk është përgjegjës për sjellje të pahijshme të pretenduara në raportin përfundimtar të ZPD-së. Nuk ka neglizhuar në kryerjen, dështim për të kryer apo abuzim të funksioneve gjyqësore, nuk ka dështuar të kryej funksionet gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe të paanshme dhe nuk ka shkelur kodin e etikës për gjyqtar, me rastin e procedimit të lëndëve kontestuese siç ka pretenduar ZPD, pas ushtrimit të ankesa në Gjykatën e Apelit - divizionin për kundërvajtje.

Sipas vlerësimit të Komisionit gjyqtari nuk është përgjegjës për vonës të dërgimit të aktvendimeve të palët, ekzistojnë flet kthesat në shkresat e lëndës, me datat kur janë dorëzuar në postë dhe me vulat e postes se kur janë kthyer flet kthesat. Gjyqtari Xxxxxx nuk ka mundur ta dërgoj lëndën sipas ankesën, në divizionin për kundërvajtje në gjykatën e Apelit, pa u kompletuar ashtu edhe siç e kërkon ligji.

Duke patuar parasysh të gjitha këto, Komisioni vlerëson se në këtë rast gjyqtari xxxxx xxxxx nuk ka kryer sjellje të pahijshme siç pretendon ZPD dhe nuk është involvuar me ndonjë veprim konkret që do të rezultonte me shkelje të standardeve të sjelljeve profesionale për gjyqtarë.

Prandaj, nga këtu dhe nga arsyet e sipër theksuara, Komisioni ka konstatuar se gjyqtari xxxxxx **nuk** është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të parapara me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika 1.2, 1.3 dhe 1.4 të ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nuk ka shkelur standardet e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar. Në seancën për këshillim dhe votim, njëzëri vendosi që xxxx xxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan të lirohet nga përgjegjësia disiplinore, prandaj vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR**  
**KD.nr.12/2017, datë 20.07.2017**

Kryetar i Komisionit Disiplinor  
Gjyqtari, Nenad Lazic

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.

Vendimi t'u dërgohet:

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Zef Prendrecaj, drejtor, Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- Xxxx xxxxx, u.d kryetar në Gjykatën Themelore në xxxxx;
- Xxxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx;
- Departamentit të Administratës dhe Personelit në SKGJK;